

Robert Elsie
E mundimshmjia “Lahuta e Malcis”
Intervistë me albanologun e njohur kanadez, pas botimeve të tij më të fundit

Prej vitesh merret me albanologji. Gjithmonë është joshur prej kësaj bote. Dhe vijon të kërkojë dejet e kulturës ende të panjohur të këtij vendi. Robert Elsie e di se është një fushë e vogël në krahasim me studime të mëdha humanitare, fjala bie, anglishtja, rusishtja apo apo gjermanishtja. “Por në këtë fushë të vogël ka ende plotë material të patrajtuar, pra ka jashtëzakonisht shumë për t’u bërë, për t’u zbuluar dhe për të botuar”, thotë albanologu i njohur në krye të kësaj interviste e cila e ka marrë shtysën nga dy botimet e tij të fundit në anglisht, që janë me mjaft interes: “Leksiku i kulturës popullore shqiptare” dhe “Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës. Pyetja e parë që hap bisedën lidhet me hapat e parë të Robert Elsie drejt albanologjisë.

[RE]: Rrugëtimi im, kuptohet, filloi shumë ngadalë. Më është dashur shumë kohë në fillim për të mësuar gjuhën shqipe, pa të cilën zor të veprosh në albanologji. Pastaj dhe me kalimin e kohës, pashë se prapa fasadës shpeshherë të zyrtë dhe të ashpër të “realitetit” shqiptar (varfëria e skajshme e përgjithësuar, prapambetja, injoranca, etj.) ishte një kulturë e pasur dhe se kjo kulturë ishte ende e panjohur dhe e pazbuluar nga bota e jashtme. “Një vend në fushëpamje të Italisë, por më pak i njohur se brendësitë e Amerikës,” kishte thënë për Shqipërinë njëherë historiani i famshëm anglez Eduard Gibon. Dy shekuj më vonë, bota e di mirë për Amerikën, por për këtë vend të vogël evropian? Thelbi i punës sime ka qenë bërja e njohur e kësaj pasurie kulturore, në mënyrë që bota të kuptojë se kush janë shqiptarët dhe që kultura shqiptare të vlerësohet në mënyrë të duhur.

[AP]: *Letërsia e një vendi të vogël, drejt një bote të madhe. Dekurajohet përkthyesi Elsie para kësaj sfide? Sa të larta janë muret që e rrethojnë letërsinë shqiptare sot dhe e ndajnë nga lexuesit e mbarë botës?*

[RE]: Besoj se do të kalojë shumë kohë para se letërsia shqiptare të bëhet e njohur në botë. Problemi kryesor është mungesa e përkthimeve të standardit të pranueshëm. Por duhet të theksohet gjithashtu se në botën anglishtfolëse mbretëron një “imperializëm kulturor”, pra një mungesë interesi, bile herë pas here një mospërfillje për kulturë të huaja, dhe për këtë arsye është mjaft e vështirë për të gjetur një shtëpi botuese për vepra të përkthyer nga gjuha shqipe. Ndërkohë, me faqen time www.AlbanianLiterature.net unë përpiqem shfrytëzoi internetin për të nxitur interes për letërsinë shqiptare dhe për autorë shqiptarë. Në vitin 2005 botova anglisht një histori të re të letërsisë shqiptare, e cila mbase do të ndihmojë që kjo letërsi të bëhet më e njohur. Libri quhet *Albanian Literature: a Short History* (Londër 2005) dhe do të botohet së shpejti edhe në gjuhën shqipe, me titullin *Letërsia shqipe: një histori e shkurtër*.

[AP]: *Të ndalojmë te dy veprat tuaja më të fundit. Njëra është “Leksiku i kulturës popullore shqiptare” (Besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore), një botim i vitit të shkuar. Nuk keni folur shumë për të. Ç’është ky libër? Ku janë gërmuar të dhënat e tij? Ç’ju tërheq te ky tradicion? A është kurioze bota anglishtfolëse për një botë të tillë?*

[RE]: Po, është e vërtetë. Ky libër doli në fund të vitit të kaluar pa shumë zhurmë, por besoj se do të jetë me vlerë edhe për lexuesin shqiptar. Libri u botua edhe anglisht *Dictionary of*

Albanian Religion, Mythology and Folk Culture (Londër 2001 dhe Nju Jork 2001) edhe gjermanisht *Handbuch zur albanischen Volkskultur* (Wiesbaden 2002) dhe u vlerësua mirë, sa e di unë. Duke qenë se ishte libri i parë anglisht dhe gjermanisht për kulturën popullore shqiptare, apo të themi më saktë për tema të caktuara të saj siç janë për shembull mitologjia shqiptare dhe besimi shqiptar, ai ka nxitur një interes në ato qarqet të vogla shkencore që merren me këto tema. Besoj se edhe për lexuesin shqiptar preken këtu tema me interes, veçanërisht kur merremi parasysh se kultura tradicionale dhe format tradicionale të besimit zhduken shpejt. Por, kuptohet, ky libër është vetëm një hap. Ai nuk pretendon të japë një trajtim të plotë të tërë veçorive kulturore të shqiptarëve. E vlerësoj shumë punën e bërë prej vitesh nga Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë dhe nga Instituti Albanologjik në Prishtinë për dokumentimin e kulturës popullore shqiptare. Për fat të keq këto institute, dhe institucione të tjera shkencore, nuk janë mbështetur financiarisht siç duhet koha e fundit, as nga shteti as nga biznesi privat, kështu që puna e tyre thelbësore nuk shfrytëzohet.

[AP]: *“Lahuta e malcís” e Gjergj Fishtës “flet” sot anglisht falë përkushtimit tuaj. Ç’mund të gjejë lexuesi i gjuhës angleze në të? A e kapërcen ai rrethin e lexuesve me qëllime më shumë studimore?*

[RE]: “Lahuta e malcís” është një kryevepër e cila ka vend në radhën e eposeve të mëdha botërore. Nuk ka se si të mos pëlqejë lexuesin, kuptohet nëse ai ka durim të lexojë një libër me 15613 rreshta. Libri u botua në Londër në vitin e kaluar, por sapo ka filluar të shpërndahet, kështu që nuk di në çfarë masë do të kapërcejë rrethin e studiuesve. Një epos letrar natyrisht nuk mund të pretendoj të jetë një “bestseller,” por të paktën u botua dhe gjendet në treg. Shohim pas pesë viteve nëse ka pasur një jehonë.

[AP]: *Nisur nga gjuha e kësaj vepre, nuk ju është dukur një aventure pak donkishoteske përkthimi i saj? E lënë në heshtje prej gati gjysmë shekull “Lahuta” për shumë kritikë është më shumë se një vepër e madhe. Si e vlerësoni ju?*

[RE]: Përkthimi ishte padyshim një mundim, dhe Lahuta ishte veçanërisht e mundimshme për mua për shkak të gjuhës, të gegërishtes letrare që përdori autori. Pra, leximi dhe interpretimi janë të vështirë, me siguri edhe për të rinj shqiptarë sot, por... “kush asht trim” do të mahnitet nga bukuria e gjuhës së autorit. Kur merremi parasysh historinë “politike” të Lahutës dhe të Fishtës, dmth. heshtjen dhe zhdukjen e eposit kombëtar për një periudhë gjysmëshekullore, ky monument kulturor merr një rëndësi të veçantë jo vetëm për Veriun por për tërë Shqipërinë, dhe bëhet më shumë se një vepër letrare. Në botimin anglisht të Fishtës, e kam quajtur “veprën e parë letrare shqiptare e cila i përket botës.”

[AP]: *Jeni shprehur dikur se “është çudi që kjo vepër është shkruar në shekullin XX”. Do të thotë një vepër jashtë kohe?*

[RE]: Pjesa thelbësore e Lahutës u hartua në fillim të shekullit XX, kurse versioni përfundimtar – nëse ishte tamam përfundimtar – u botua në vitin 1937 në rastin e përvjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Po të krahasojmë Lahutën me epikët e tjera letrare, në veçanti me epikët kombëtare të Evropës, ta zëmë me veprat e Njegoshit malazez, të Mickieviçit polak, të Dantes italian, të Donelaitisit lituanez, të Kamoeshit portugalez etj, shohim se Lahuta e Malcís është shumë vonë. Por, siç e dimë, Shqipëria e vogël është pak vonë në çdo gjë, apo jo? Dhe kjo nuk do të thotë se është më keq. Ne themi anglisht “last, but not least” (i fundit

nga radha, por jo nga rëndësia).

[AP]: *Sa e vështirë është të merresh me albanologji në këto kohë?*

[RE]: Albanologjia gjithmonë ka qenë një fushë e veçantë – e paorganizuar, pa strukturë, pak kaotike. Në nivelin ndërkombëtar ajo përbëhet nga individët e ndryshëm me interesa krejt të ndryshme dhe me pak kontakt me njëri tjetrin. Nuk ekziston asnjë “shoqatë profesionale” me konferenca të rregullta ndërkombëtare, asnjë institut albanologjik jashtë trevave shqiptare ku mund të merresh seriozisht me albanologjinë, asnjë formim profesional. Kuptohet se këto mungesa nuk lehtësojnë punën, por nga ana tjetër, bota është shumë më e vogël tani. Kemi internet, kemi email, dhe mund të shfrytëzojmë këto mjete për një komunikim shumë më efektiv. Unë kam futur gati të gjithë artikuj të mi, dhe shumë libra të tërë në internet, në faqen time www.elsie.de, dhe këto vepra albanologjike lexohen shumë më shumë tani se kurrë më përpara kur u botuan. Me faqet e tjera që kam hapur: për letërsinë shqiptare (www.AlbanianLiterature.net) dhe së fundi për historinë shqiptare (www.AlbanianHistory.net), mund të përhap informacione për kulturën shqiptare menjëherë dhe kudo në botë. Sipas statistikave që disponoj, këto faqe interneti hapen dhe lexohen më shumë se 2000 herë përditë, dhe kudo në botë, nga Brazili deri në Kinë. Është një revolucion ky mjet i cili duhet të shfrytëzohet më shumë për albanologjinë.

[AP]: *Dhe së fundmi, cili është preokupimi juaj i momentit?*

[RE]: Siç thashë më lartë, libri im i ri *Letërsia Shqipe: një histori e shkurtër* do të botohet së shpejti në Tiranë nga Skanderbeg Books. Në verë të vitit 2006 do të botoj në SHBA një antologji të tregimit bashkëkohor shqiptar, pra antologjinë e parë të prozës shqipe në gjuhën angleze. Ky libër me titull *Balkan Beauty, Balkan Blood* do të botohet nga Northwestern University Press, besoj në qershor. Gjithashtu, sapo kam mbaruar një projekt tjetër të madh, një antologji të poezisë shqiptare anglisht, e cila përfshin poezinë shqiptare nga shekulli gjashtëmbëdhjetë deri me sot. Merrem edhe me disa projekte të tjera afatgjatë, por kjo është një rrëfim për një kohë tjetër kur konkretizohen.

intervistoi Admirina Peci

[botuar në: *Gazeta shqiptare*, Tiranë, 16 prill 2006, f. 34 / Published in: *Gazeta Shqiptare*, Tirana, 16 April 2006, p. 34.]